

# PUKA DHE RRENJET E SAJ TE TRASHEGIMISE ETNO-KULTURORE NE SHEKUJ

Muhamet CUFAJ

Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

## PËRMBLEDHJE

Uniteti i përkatësisë etnografike të Pukës është i shprehur në veshjet tradicionale, ndërtimet e banesave, në krijimet gojore e muzikore, në vallet, doket, në mënyrën e jetesës dhe në të folmen e përbashkët të Pukës. Nga pikëpamja kostumologjike, Puka ndahet në tri rrethina e konkretisht: Veshja Pukës, (pellgu i Gominës, gratë e besimit katolike), Kabashçe (gratë myslimane të fshatrave të Pukës) dhe Pultake (Brigjet e Drinit) dhe veshja e grave të Komanit. Theksoj se si rreth 1/3 e Pukës është Mirditë (nga 73 fshatra të kësaj treve 30 prej tyre banojnë nga Mirditorë).

*Fjalë kyce: valle, doke, lagune, vigje, fqinj, livadh.*

## ABSTRACT

The unity of the ethnographic affiliation of Puka is expressed in the traditional costumes, the construction of dwellings, in the oral and musical creations, in the dances, the docks, in the way of life and in the common dialect of Puka. From the costume point of view, Puka is divided into three suburbs namely: Veshja Puka, (Gomina basin, women of the Catholic faith), Kabashe (Muslim women of the villages of Puka) and Pultake (Drini Banks) and the ear of Koman women. I emphasize how about 1/3 of Puka is Mirdita (out of 73 villages in this area 30 of them are inhabited by Mirdita).

*Key word: dance, mores, lagoon, beams, neighbor, meadow.*

## HYRJE

Rrethi i Pukës, ky oaz natyror, i shtrirë në Shqipërinë verilindore qendrore, me një sipërfaqe 1036 km<sup>2</sup>, ka trashëguar në shekuj, brez pas brezi pasuri dhe vlera të çmueshme të kulturës materiale, shpirtrore e kulturore, vlera të cilat për shumë elementë mundësojnë dashamirësit, historiografisë dhe etnologjisë studiuesit, që të thellojnë analizat e krahasimet e tyre. Pozita gjeografike me kufi natyror, lumin më të madh dhe ujëshumë DRININ, nga Vaospasi e deri në Karmë, e kufizon me Krumën, Tropojën, Shkodrën, Qafë Shllak, Goskë –VaSpas kufizohet me Kuksin, ndërsa nga Qafë Shllak, Qafë Mali zbrit në rrjedhën e sipërme të Fanit të Madh, Lumë-Shtyllë kalon Suken e Zezë, Qafa Kumbullës del në majën e Thatë, livadh Kabashe duke lënë Malin e Tërbunit në anë të Pukes, kalon përmes Gomsiqje, kalon në katundin Mdhue e pastaj zbrit në Drin, është kufiri etnografik i Mirditës. Konfiguracioni i terrenit tepër malor me mundësi të vështira komunikimi mes fshatrave e zonave (male të larta, lugina të thella) popullimi i fshatrave dhe vendbanimeve nga banorë me tradita, zakone, sjellje e qëndrime të afërta dhe të ndryshme, ka bërë që të ruhen e të konservohen më mirë, më afër origjinalitetit e më gjatë në kohë të elementëve etnografikë. Puka si krahinë etnografike e vendit tonë, u formua në kushte të caktuara historike, hapësinore e kohore, brenda të cilave pati dallime e ndërlidhje krahinore e ndërkrahinore. Uniteti i përkatësisë etnografike të Pukës është i shprehur në veshjet tradicionale, ndërtimet e banesave, në krijimet gojore e muzikore, në vallet, doket, në mënyrën e jetesës dhe në të folmen e përbashkët të Pukës. Nga pikëpamja kostumologjike, Puka ndahet në tri rrethina e konkretisht: Veshja Pukës, (pellgu i Gominës, gratë e besimit katolike), Kabashçe (gratë myslimane të fshatrave të Pukës) dhe Pultake (Brigjet e Drinit) dhe veshja e grave të Komanit. Theksoj se si rreth, 1/3 e Pukës është Mirditë (nga 73 fshatra të kësaj treve 30 prej tyre banojnë nga Mirditorë).

## **PUKA DHE RRENJET E SAJ TE TRASHEGIMISE ETNO-KULTURORE NE SHEKUJ**

### **Historia**

Në Lashtësi Puka përfshihej brenda trevës veriore të fisit ilir Pirust, i njohur si shkrirës dhe përpunues metalesh. Zhvillimi ekonomik gjatë Antikitetit dhe Mesjetës i dhanë shkas përparimit të jetës qytetare me qytetet apo qytezat, si: Ad Picaria, Puka, Shqeli, Delmace, Gralisht, Iballe, Crevenum (Spas), Sarda (Shurdhahu) etj. Vetë qyteti i Pukës ka një histori mbi 2000 vjeçare, e cila dokumentohet në hartat romake të shekullit të II-IV, në të cilat shënohet me emërtimin Ad Picaria e shqipëruar Pezhve( Pezhvja është vendbanim, emrin të cilit ia ka dhënë zej i prodhimit të pezhves, llojë vaj pishe, që përdorej për vajisjen e mekanizmave për lehtësimin e lëvizjeve duke ulur fërkimin).

### **Fillimet e veprimtarive jetësore**

Me përqendrimin e njerëzve në vendbanime sipas gjakut, fisit dhe më vonë sipas fshatit e krahinës, filloi edhe hapja e rrugëve dhe shtigjeve për lidhjen mes lagjeve, fshatrave e krahinave. Shtigjet u hapën edhe për lidhjen e fshatrave me pyjet, për efekt kullosash, mbi prrenjë u hodhën vigje (polovigje) me lëndë druri, apo me trina për lidhjen e dy brigjeve, si dhe u gjetën vende kalimi më të gjëra e më të qeta për kalimin në ujë, apo dhe me not, për njerëzit dhe për kafshët. Këta vende të shtrira në lumenjtë e rrëmbyeshëm e me ujë shumë u quajtën VA. Kufizimi i jetës brenda fshatit nuk mundësonte zgjerimin e njohjes, të vendosjes së marrëdhënieve ekonomike, shoqërore e miqësore. Me zgjerimin e lëvizjes dhe shtimin e komunikimit u realizua integrimi dhe harmonizimi i veprimeve të përbashkëta për zhvillim, punë, tregëti e për mbrojtje. Gradualisht lindi nevoja e këmbimit të mallrave e prodhimeve, tregëtia e vogël, çka erdhi duke u zgjeruar, kualifikuar dhe perfeksionuar. Për të realizuar këtë në mënyrë të organizuar u hapën shtigje kalimi (drume, rrugë, nga kalonin tregtarët, kafshët e ngarkesës). Si pikë e ndërmjetme, Puka dhe gjithë hapsira e saj malore me një terren shumë të thyer, mori mbi vehte sigurimin e karvaneve tregtare. U ngritën pika pushimi të përkohshme, hane (bujtina) për njerëzit, stalla për kafshët e ngarkesës dhe dugaja e menca, ku shërbehej ushqimi. Tregëtia filloi të shtrihej edhe me qytetet e mëdha të anës prendimore të vendit me ato të lindjes: Shkodër e Lezhë me Prizrenin e Gjakovën.

### **Rrugëkalimet më të rrahura e të sigurta ishin:**

1. Gjakovë - Vau i Fierzës – Iballë – Sapaç – Tmug – Midhë – Bushat - Kodër Bojë – Qelëz - Dedaj – Qafë Qerreti – Skaje - Dush i Poshtëm - Gomsiqe - Vau Dejës - Gur i Zi – Shkoder, udhëtim shumë i gjatë dhe i vështirë.

2. Gjakovë – Krumë - Va Spas - Flet – Qafë – Mali - F. Arrëz – Rrape – Pukë – Kçirë – Skaje - Gomsiqe - Hani i Sulit - Va Dejës - Gur i Zi - Shkoder.

Kalimi i njerëzve, mallrave e kafshëve në Dri ishte gjëja më e vështirë dhe e rrezikshme. Voztarët e Vave, ishin notar të zot, ata shpesh vinin vehten në rrezik për të kryer detyrën sa më saktë. Kanë shkrojtur emrat e tyre të lavdishëm voztar si: Zmajl Pjetra, për më se 6 breza, Nikë Zmajli, Ndue Nika, Mark Hyseni, Prend Jaku të gjithë nga Fierza e Pukës e me ta dhe ata të Vaspasit e të Va Dardhës, që ishin vend kalime më të qeta e më pak të rrezikshme. Përveç Va Spasit, të Dardhës e të Fierzës, ka pasur edhe vend kalime të ndërmjetme, të cilat shërbeheshin nga banorët e breg Drinit, si në Bushat, Berishë, Svinë, Mertur, Apripë, Miliska, Mëzi, Truen, etj. Notarët përdornin rrëshiqët, që ishin mjetet e vetme të përdorshme, po aq dhe të rrezikshme, se mund të dilnin mbi ujë e të fundosnin udhëtarin.

Drini ka qenë lumë tepër i rrembyeshëm dhe i rrezikshëm, shumë jetë kalimtarësh janë humbur në ujrë e tij. Populli i ka shprehur në vargje vajtuese humbjet e dhimbshme: Drin, o Drin, ti kofsh i zi, qysh na i mbyte ata djem të ri. Ti shterrofsh e u bëfsh përrue, qysh na i mbyte burrë e grue, rana e shtratit t'u baftë prush, qysh na i mbyte nuse e krushq. Deri vonë as ura mbi Drin nuk ishte hedhur, ndaj kalimi i tij realizohej me trap, i cili ishte i lidhur me kavo e nëpërmjet karrukullës lëvizej nga njeri breg në tjetrin, nëpërmjet tij kalonin edhe mjetet e transportit të mallrave.

Në vitin 1952 u këput kavoja dhe i “dhuroi” Drinit 20 jetë udhëtarësh së bashku me automjetin e tonazhit të lartë. Rapsodi popullore e përshkruan këtë dhimbje të trishtueshme me vargjet: *Hysen Ibra ni djalë i ri, / Po shkon Drinit tuj qitë allti, / Isuf Nimani e njofti n'za: - Hysen Ibra, tha more vëlla, A po e sheh se n'Dri kam ra. Sall pak hana me pas zdritë.* Tetëmbëdhjetë vetë n'Dri s'ishim mbyt (për këto drama e për ndryshimet e bëra ka shumë për tu thënë, po i solla këto shembuj, se tregtia si mardhënie ekonomike mes dy pjesëve të vendit tonë, ku vendkalim ka qenë Malësia e Pukës me relievin tepër të thyer dhe me konfiguracion mes luginash, malesh, qafash, lumenjësh, klimash të ndryshme, ka vështirësuar komunikimin, por ka vu në provë dhe ka konsoliduar shumë cilësi të karakterit burror të pukjanit: mikpritjen, përcjelljen dhe sigurimin e udhëtarëve brenda kufinjëve të fshatit dhe përcjelljen e dorëzimit në fshatin tjetër shëndosh e mirë, sipas Kodit të Besës.

Në shek. VI - VIII bëhet e njohur “Kultura e Komanit” në Delmace, një kulturë materiale qytetare arbërore mesjetare të një ekonomie të zhvilluar zejtare vendase në një mjedis bashkësie fshatarësie aktive. Me këtë zhvillim ekonomik dhe me qendrat urbane ndër shekuj, ka qenë e lidhur edhe prania e një rrjeti të shumtë institucionesh të rëndësishme të kultit të krishter e më vonë islamik, si peshkopatat në Delmace e shekullit IV-VIII, Koman Pukë, Sarda, Dukagjin (Spas) dhe Abacia e Shën Palit në Kabash e ndertuar në Grykë të Kabashit. Kjo kishë është ama e gjithë kishave të Pukës. Sipas dokumenteve, ajo është ndërtuar që në shekullin e IV dhe ka qenë qendër episkopale për zonën e Pukës, dhe e radhitur si një nga më të vjetrat në Ballkan.

Kisha e Thaçit e Iballes (Kishë edhe kjo shumë e vjetër dhe një qendër peligrinazhi e bamarsie e krahasuar me atë të Laçit), Xhamia e Pukës, Xhamia e Dukagjinit dhe Teqja e Simonit (Spas), etj., Principata e Dukagjinit e shekullit XIII-XV, përmbledh në juridiksionin e vet njësi administrative, politike, kulturore, ekonomike dhe fetare territorin e Pukës e njohur me emrin Dukagjin në relacionet e tij të viteve 1637-1638 Frang Bardhi, ka artikulluar si Dukagjin vetëm popullsinë e trevës së Pukës. Në vitet 1878-1881 dhe 1885, Puka u bë mbështetje e sigurtë e lidhjes Shqiptare të Prizrenit, së cilës jo vetëm i dha luftëtarë e mbështetës, por edhe ideator, udhëheqës dhe mendimtar mes të cilëve zënë vend nderi personalitetet e Pukjanë: Ismail Agë Kryeziu, hoxhë Puka, Musa Dizdari etj.

Edhe në vitet 1911-1912, Puka u përfshi në qëndresën anti serbe dhe çliroi krahinën e tij më, 07.09.1912. Duhet theksuar se qendresa e Dukagjinasve (ku përfshihen krahinat e Mirditës, Malsisë së Dukagjinit, Pukës e më gjërë), u organizuan dhe u mbledhën gjithë krerët e fiseve pa dallim krahine, bajraku, feje e përkatësie dhe nën drejtimin e Terenc Toçit më 27 prill 1911, fill një ditë pas organizimit të Kuvendit Ndershtetror të Fanit, në të cilin morën pjesë krerët dhe bajraktarët e Mirditës, Shalës, Shoshit, Berishës, Thaçit, Thethit, Mërturit, Nikajve, Toplanës, intelektualë shkodranë dhe disa arbëreshë me në krye Terenc Toçin. Në mbështetje të tyre ishin edhe atdhetarët e shquar si: Isa Boletini i Mitrovicës, Sulejman Agë Batusha i Malësisë së Gjakovës, Osman Agë Berisha i Berishës, Beqir Halili i Krasniqes, Halit Brahimi i Gashit, Dedë Gjo Luli i Hotit, Zenel Shabani i Kastratit, Isuf Doda i Lurës, e të tjerë, dhe pikërisht në fshatin Kimëz, po nga zoti Terenc Toçi e nën drejtimin e tij, u shpall krijimi i Qeverisë së parë Shqiptare, që pas vdekjes së Skenderbeut, edhe Pavarësimi i krahinës si dhe u ngrit Flamuri i Arbrit me pjesëmarrjen e fiseve dhe përfaqësuesve nga: Spaci, Fani, Gojani, Oroshi, Kushneni, Kthella, Shkodra, Dibri, Merturi, Berisha, Shala, Shoshi, Thaçi, Toplana, Thethi, Nikaj.

Gjesti i Atdhetarit Dod Luli, me ngritjen e Momerialit të Qeverisë së Kimzes, është shembull, që duhet ta ndjekin edhe Qelzorët, Iballasit, Kabashasit si dhe vetë bashkia e Pukës për memoriale e studime për kuvende, takime e besëlidhje, që sjellin memorien kombëtare dhe nderojnë vend organizimet e tyre, si dhe evidentojnë nxjerrin në dritë të figurave organizuese. Eqerem Bej Vlora, një personalitet i shquar dhe njohës i mirë i çështjes shqiptare shkruan për këtë ngjarje kryesore në historinë Kombëtare Shqiptare: “Në kohën e kryengritjes së malësorëve katolikë, në vitin 1911, në Cetinjë mbërritën vullnetarë arbëreshë për t'u bashkuar me kryengritësit, e që për herë të parë mbanin një flamur kombëtar.

Njëri nga krerët e këtyre vullnetarëve quhej Terenc Toçi. Në krye të një grupi vullnetarësh e malësorësh, ai çau deri në Mirditë, ku edhe shpalli një Republikë shqiptare, doemos jetëshkurtër, që me ngritjen e flamurit shqiptar për disa ditë rresht ngriti fuqishëm moralin e popullit. Madhështore në këtë aksion, të thuash operetë, ishte besnikëria ndaj etnitetit shqiptar që arbëreshët dëshmuuan me qëndrimin e tyre: “Ata luftuan me trimëri të rrallë e pa asnjë mëdyshje, thuajse me gëzim, rrezikuan jetën e tyre, duke u dhënë kështu zemër edhe vëllezërve në atdheun e lashtë e të braktisur para aq kohësh”.

Në shek. XI – XII krahina e Pukës përfshihet në principatën e Veriut, të Centës, kurse brenda vendit në trevën krahinore “Pulatum”. Më pas, Puka konsolidohet si një nga krahinat më kryesore të principatës së Dukagjinëve, por pa i humbur të gjitha lidhjet e mëparshme me trevën veriperëndimore të vendit, pra, me Pultin. Kjo lidhje shprehet në ruajtjen e veshës pultake, si dhe lidhjet me ciklin e kreshnikëve, me kuvendet, me lidhjet fisnore si dhe me përdorimin e instrumenteve muzikore mes të cilave veçohet lahuta. Rritja e forcimi i principatës së Dukagjinëve me shtrirje në një trevë më të gjerë, Puka, Mirdita, Luma, Hasi, Rrafshi i Dukagjinit, Zadrima etj, dhanë shkas për një zhvillim të mëtejshëm dhe të qendrueshëm ekonomik social e kulturor të përbashket. Marrëdhëniet ekonomike janë një arritje tjetër te cilat kanë një pasqyrim shumë të gjërë. Në këto marrëdhënie përfshihen: udhët e shtigjet, bujtinat e dugajat, ndamja e shtëpise, shitblemja, dhënia e tokës me fitim e ndërrim (tram), punëtori, hua me pagë dhe me borxh, dëmi dhe dënimet, etj.

Mbrapshtinat kundër jetës me vrasje, përdhunimet, gjakmarrjet, pajtimet e gjaqeve dhe masat kanunore të parandalimit të gjaqeve, zënë një vend të rëndësishëm, si shprehje e humanizmit dhe e unitetit të popullit për të jetuar populli në paqe e harmoni. E shoh me vend të theksoj, se ka patur që në lashtësi një organizim të brendshëm shkëmbimesh ekonomike. Zejet u zhvilluan në secilin fshat, po tregëtimi i produkteve të prodhuara nga zejtarët e prodhuesit popullor gjetën hapsirë të veçantë tregëtimi edhe në *Panairin e Kabashit*.

### **Besëlidhja e madhe e mirditorëve**

Në vitin 1565 u mblodhën dhe lidhën besën kundër turkut malësorët e tri maleve fqinje, të Mirditës, Pukës dhe Lumës, të cilët ndërprejnë rrugën strategjike Shkodër - Prizren që me sulme të shpejta e të befashme goditën në disa pika rregjimentet turke në afërsi të Shkodrës. Për të shtypur këtë kryengritje të kësaj besëlidhjeje, pushtuesi osman përdori regjimentet e Shkodrës, Dukagjinit dhe të Ohrit. Mbas disa luftimeve të rrepta që vijuan me furë për disa kohë, kryengritësit u tërhoqën në male, ku nuk mund të depërtonte turku për arsye se pësonte humbje të mëdha. Në regjistrat osman të Sanxhakut të Dukagjinit në vitin 1571 për Mirditën nuk gjenden të dhëna popullsie, por shkruhet se *Rajata e Nahisë së Fanit u treguan kokëfortë dhe nuk erdhën të rregjistruhen*.

### ***Pak histori për panairin e Kabashit***

Sipas historianëve thuhet, se panairi i fshatit Kabash është zhvilluar para shekullit të 13-të. Ai zhvillohej çdo ditë të dielë, e cila njihet edhe me emrin “*Dita e Luleve*”, dhe e “*Diela e enëve*”. Panairi shtrihej në dy anët e rrugës, e cila njihet si Rruga e “*Karvanave*”, Rruga e Gjakovës, etj. Tradita thotë, se dikur Panairi shtrihej në gjithë fshatin përbri rrugës së hershme të karvanave prej “*Qafë- Ajtyres*” deri në “*Qafë gjanë*”. Fshati Kabash njihet dhe respektohet si Bajrak i Parë në zonën e Pukës, po ashtu dhe si qendër e Kuvendeve fisnore dhe ndërfitnore. Përveç faktit e të qenurit fis i parë, Kabashi njihet për traditën e mirë ndër fetare. Kronikanë të ndryshëm e kanë përmendur panairin e fshatit Kabash që në vitin 1637. Në panairin e Kabashit mund të merrnin pjesë kush të dëshironte, pa dallim fisnore a fetare, krahinore a shoqërore. Sipas të dhënave, Panairi kishte rëndësinë e vet si për malësorët, po ashtu edhe për udhëheqësit e vendit. Në këtë Panair merrte pjesë e gjithë krahina e Pukës, duke përfshirë edhe zonën e Gjegjanit e Kashnjetit. Po ashtu thuhet, se në këtë panair kanë marrë pjesë edhe nga Shkodra dhe nga Lezha. Aty lidheshin marrëveshje tregtare, të cilat luanin një rol të rëndësishëm për mirëqenien e vendit.

Tregohet se panairi i Kabashit ka qenë i pasur, kur pjesëmarrësit përgatisnin pjesë artizanale. Kabashi nxirrte në treg punime druri, leshi, enë prej balte, etj.

Ndersa, **Kryeziu, Gojansit, apo Sakati, Pista**, etj, kishin zanat të paraqiteshin me vegla, punime hekuri të punuara nga kovaçët të ndryshem. Në panair nuk mungonin orendi, e zbukurime të ndryshme. Në panair nuk mungonin as veglat muzikore si: çiftelia, lahuta, fylli zumare, daulle, etj. Në zonën e Pukës dhe jo vetem është shumë e njohur vallja e Kabashit, e cila kërcëhet edhe sot. Përveç faktit e të qenurit fis i parë, Kabashi njihet për traditën e mirë ndër fetare. Në panairin e Kabashit mund të merrnin pjesë kush të dëshironte, pa dallim fisnor a fetar, krahinor a shoqërore. Sipas të dhënava panairi kishte rëndësinë e vet, si për malsorët, po ashtu edhe për udhëheqësit e vendit. Në këtë panair merrnin pjesë e gjithë krahina e Pukës, duke përfshirë edhe zonën e Gjegjanit e Kashnjetit.

Po ashtu thuhet se në këtë panair kanë marrë pjesë edhe nga **Shkodra dhe Lezha**. Në këtë panair lidheshin marrëveshje tregtare të cilat luanin një rol të rëndësishem për mirëqënien e vendit. Tregohet, se panairi i Kabashit ka qenë i pasur, kur pjesëmarrësit përgatisnin pjesë artizanale. Kabashi nxirrte në treg punime druri, leshi, enë prej balte etj. Ndërsa **Kryeziu, Gojansit, Sakati, Pista**, etj kishin zanat të paraqiteshin vegla, punime nga hekuri të punuara nga kovaç të ndryshëm. Në panair nuk mungonin orendi, e zbukurime të ndryshme. Në panair nuk mungonin as veglat muzikore si: **çiftelia, lahuta, fylli zumare, daulle**, etj. Në këtë panair është zhvilluar shumë edhe lënja apo marrja e porosive të ndryshme. Në shumë raste njerëzit kishin klientët e vet. Mallrat e porositur u shkonin njerëzve nëpër shtëpi. Veçori e panairit ishte rregull që të gjithë vishnin rrobat më të mira të traditës ose i merrnin nga të tjerët për të rënë në sy si një ditë feste. Panairi përveç tregëtisë ishte i ndërtuar në atë mënyrë që të ishte një festë e vertetë. Organizoheshin edhe sporte, qitje me pushkë në shenjë.

Ky panair shfrytëzohej edhe për takime e miqësi të ndryshme. Tregohet se ky panair merr peshë dhe rëndësi të madhe edhe për shkak të Kuvendit të Malësorëve (të Bajraktarëve), i cili zhvillohej në zonë mes fiseve duke mbajtur rend, siguri si dhe duke luajtur rol të rëndësishme në pajtimin e gjaqeve. Kuvende të tilla krahinore zhvilloheshin rregullisht në Kabash, ku rol të veçantë si gjithmonë kanë luajtur edhe dy besimet fetare ai mysliman e katolik. Keto ishin disa tipare kryesore te fizinomisë së panairit të Kabashit, i cili është një ndër vlerat dhe traditat më të vyera të Pukës. Dukagjini deri në vitet 1280 kishte në zotërim viset: Iballe, Spaç e Fan. Deri më 1430 Dukagjinët u ndanë në dy degë, ku Puka, Iballa, Spasi, Zadrima i përkasin degës së Pal Dukagjinit, Nikoll Lekës dhe Stefan Dukagjinit. Në këtë kuadër u rritën mundësitë për integrimin e ndërthurjen më të madhe të kulturës materiale, shpirtrore, shoqërore dhe artistike.

Ky unitet i gjithanshëm u shpreh në shekuj në sjelljet, qendrimet e mardhëniet e përbashkëta të afërta e të largëta mes etniteteve të ndryshme, mes krahinave, të cilat iu bashkuan në jetën e veprimtarinë e përbashkët kësaj principate. Sjelljet, qendrimet, mardhëniet ekonomike, sociale e kulturore iu nënshtruan rregullave e sulleve, që vetë komunitetet me vullnetin e tyre i pranonin dhe iu nënshtroheshin në zbatimin e tyre me vetëdije të lirë dhe që më pas edhe të detyruar. Të gjitha këto rregulla të bashkëpranuara u mblodhën dhe u sistemuan në atë kod ligjor që u quajt Kanuni i Lek Dukagjinit. Princi Lekë Dukagjini (Leka III) që bashkëkohës i Skënderbeut dhe vazhdues i luftës mbrojtëse anti osmane, sidomos në mbrojtje të qyteteve: Krujë e Shkodër. Ai mori pjesë në drejtimin e Kryengritjes së vitit 1481. Të gjitha këto e bënë Lekë Dukagjinin (Lekën III) një personalitet historik të nderuar në kujtesën e popullit, sidomos në trevën e Dukagjinit Mesjetar, ku ka sunduar.

Çdo ngjarje historike, çdo traditë të asaj kohe malësorët e lidhinin me emrin e Lekë Dukagjinit. Në Malësi, ligjet, doket, zakonet dhe shprehitë, i atribuoheshin Lekës - theksonte E. Durham në shënimet e saj. Jo vetëm ana sociale, zakonet, doket, sjelljet e qendrimet i atribuoheshin prijësit Lekë Dukagjinit: kështu ka thënë Leka”, “e ka vendosë Leka”, “sipas Lekës”, etj., etj., po edhe emërtimet e objekteve mbrojtëse, të vend mbledhjeve të kuvendeve, mesjetare në krahinën e Pukës e më gjerë morën emërtimin

e Lekë Dukagjinit, pa marrë parasysh, se kush mund të ketë qenë sundimtari i parë i objektit në fjalë. Këto emërtime janë ruajtur deri në ditët e sotme. Kështu ndeshemi me disa prej tyre: Kalaja e Leks në Kabash, kalaja Leks në Micoj, Kala Leks në Breg, Kalaja Leks në Flet, Kulla Leks në Pap (Berishë), Kalaja Leks në Dardhë, Kalaja Leks në Vaspas, Kalaja Leks në Shumri, etj., Lisi i Leks, Panja e Leks në Kimëz etj., etj. E drejta dokësore shqiptare, zakonore, e cila në treva të ndryshme u atribuohet personaliteteve historike, si: Skënderbeut apo Lekë Dukagjinit, etj. Zanafillën duhet kërkuar në origjinën e hershme dhe në evoluimin e tyre sipas stadeve të lëvizjes së popullsisë, zhvillimit të tyre shoqëror dhe ekonomik gjatë shumë e shumë shekujve. Ky evoluim e zhvillim social përbën nënshtratin e së drejtës zakonore dhe të kulturës juridike të kombit shqiptar.

Është e ditur se në treva e krahina të ndryshme kjo e drejtë, ky zhvillim, ky integrim social dhe ekonomik i përbashkët merr ngjyrim dhe element edhe lokal, duke dhënë variante të një karakteri më të ngusht krahinor, por asnjëherë pa u shkëputur nga elementët bazë të variantit të përgjithshëm. Këto element më mirë se kudo i takojmë në veshje, në raportet, qendrimet dhe mardhëniet mes banorëve të një gjaku, fshati, fisi apo krahine, në ceremonitë e ndryshme të gëzimeve e fatkeqësive, në shtresëzimet e kulturës së shprehjes (artikulim), në leksik, në emërtim, në krijimtari dhe interpretim të artit popullor: valle, këngë, lojra popullore; në mardhëniet e qendrimet e banorëve ndaj pronës vetjake e të përbashkët, në ritet e besimet dhe në shumë e shumë elemente të tjera, që aq bukur, duke iu nënshtruar karakterit shkencor, janë mbledhur e sistemuar nga studiuesi Xhemal Meçi në dy variantet për Pukën dhe Mirditën, variante të cilët, edhe pse kanë një burim, paraqesin në disa anë të veçanta të cilat bëjnë dallimin e këndvështrimit mes tyre.

Është me rëndësi njohja e tyre, pasi rrethi i Pukës, si njësi administrative në përbërje të saj përfshinë rreth 40% e mos më tepër popullsi të Mirditës. Të flasësh për Kanunin dhe ideatorin me të cilin është i lidhur emërtimi i tij, Lek Dukagjinit, lipset një analizë e thellë dhe e gjithanshme, (gjë e cila nuk është objekt i këtij shkrimi), po referimi apo anashkalimi nga ai, kur flitet për etnosin popullor, për zakonet e doket, për sjelljet e qendrimet sociale në shekuj, ndaj tij nuk mund të shkëputesh, sepse aty dhe pikërisht aty, janë të mirësanksionuara elementët më thelbësor referuese. Nga krahina e Pukës dhe principata e Dukagjinëve kanë dalë shumë figura të shquara të kombit tonë të cilat renditen në panteonin e elitës kombëtare dhe i japin nderë e lavdi atij. Mes tyre mund të përmendim familjet fisnike të Gazullëve (Gjon, Andrea e Pal Gazulli), Pal, Nikoll e Lekë Dukagjini, Shtjefen Gjeçovi, Ismail Kryeziu e shumë e shumë të tjerë. Në traditat e hershme popullore te trevës sonë të Pukës hyjnë shumë element, por ne do të paraqesim një vëzhgim të shkurtër mbi: banesat, zejtarinë, veshjet, këngët, vallet, ritet në dasma e morte etj.

**1. Banesa** - Trashëgimia arkitekturore në këtë trevë zë fill qysh në kohet e lashta, në Iliri. Aty gjejmë ndërtime në qyteza dhe në kala, muret e të cilave janë të ndërtuara me gurë të përmasave jo fort të mëdha si në krahinat e tjera (unë vlerësoj, kjo më tepër shpjegohet nga konfiguracioni i terrenit), në të shumtën e ndërtimeve të tilla ndeshen gur të palatuar, e aq më tepër, jo gjithëkund janë të lidhur me llaç (gëlqere). Banesat janë vendosur mundësisht në vende me mbrojtje natyrore, në vende të pjerrëta, larg rrëshqitjeve, në kodra, mbi shkëmbinj etj. Karakteristikë e vendosjes së banesave ka qenë banesa të veçuara, me krahë e, më tepër me shpinë të mbrojtur. Banesa në trevën e Pukës ka kaluar në disa faza:

**a.** Banesë një katëshe (përdhesë), dy katëshe dhe më vonë ka ardhur deri në ditët tona banesa tre katëshe tip kulle. Banesa u përshtatej kushteve të jetesës dhe rrethanave luftarake. Ndër format më të preferuara të banesave mbizotëronin kullat e tipit të Malësisë.

**b.** Banesa tip kulle është një zgjedhje e zgjuar e asaj periudhe historike duke e vendosur atë gjithnjë në pozicione strategjik. Banesa tipike të tilla, edhe pse të rralla, i takojmë në gjithë hapësirën e Pukës.

Banesa dy katëshe, me gurë të lidhur me llaç dhe me hatulla (baltë dheu), me gëlqere është tipike e ashtuquajtura jerevi. Trolli i kësaj banese hapej në dy nivele duke iu përshtatur terrenit të pjerrët. Në

nivelin e parë ngrihej kati i parë me mur guri dhe llaç dheu e me breza druri. Mbi të ngrihej kati i dytë i ndarë ky në dy lloje materialesh, pjesa direkte ndërtohej me material druri, dërrasa sëpate, të futura në kanal in e dyrekve nga ana e jashtme, ndërsa nga brenda vishej me dërrasa të zdrukthtuara e të zbkuruara. Në mes hapësira mes dy tipeve të dërrasave, për të siguruar ngrohtësinë mbushej me baltë të shkelur, ose me materiale të tjera, që siguronin elementin e ruajtjes së nxehtësisë, eliminonin zhurmat etj. Kjo pjesë lidhej me pjesën tjetër, që i afrohej stomit në disa raste, por edhe mund të ishte e larguar prej tij, e ndërtuar me mur guri dhe llaç dheu të ngjeshur, i lidhur me breza. Këta dy pjesë të banesës lidheshin e mbi te vendosej çatia. Çatia, sipas zonave për të siguruar rrëshqitjen e dëborës ngrihej e pjerrët, dhe në këto raste ngriheshin kallkanët në dy anësoret e ngushta (mur në formën e një trekëndëshi barabrinjës). Tavani i lartë mundësonte që hapsira të shfrytëzohej për ambiente fjetjeje për çiftet e shtëpisë. Zakonisht në katin e parë strehoheshin bagëtia. Kjo hapsirë kishte dritare të vogla për ajrosje. Dera e cila dilte në trellin e bagëtisë, mbyllej nga brenda dhe lidhej me katin e dytë me shkallë nëpërmjet kopanxhës (zavrakut). Kjo për të siguruar bagëtinë nga grabitësit, që nuk ishin të pakët, të cilët thyenin shtëpitë e mirrnin bagëtitë.

Pjesa e katit me dru (dërrasë) kishte një dhomë të madhe e (burrave), ku mund të shtroheshin 4-5 sofa, rreth së cilës mblihdeshin 10-11 persona, afërsisht mbi 40 m<sup>2</sup>, kjo sipas gjendjes ekonomike të familjes. Aty mblihdeshin burrat dhe të rinjtë e familjes, si dhe priteshin miqtë e dashamirët, organizoheshin ceremoni, kuvende, luheshin lojra popullore. Porta e jashtme e banesës kalonte në një koridor katror. Në këtë koridor ishte dera e odës së “mirë”, dera e një dhome fjetjeje në krahun e odës së mirë (madhe) dhe dera, që futej në pjesën e granisë, pjesës me mur guri. Në të dy ndarjet kishte oxhakë për zjarr me dru. Në pjesën e granisë ishte këndi i gatimit, i ruajtjes së ushqimeve, maxhja dhe furra e bukës. Kjo hapsirë në të shumtën e rasteve nuk shtrohej me material drusor, as prej guri, por ishte direkt në tokë, në dhe, të ngjeshur. Brenda kësaj hapsire ndërtoheshin odat e çifteve të shtëpisë, apo e të moshuarve (zakonisht dy të tilla). Kati i drunjte në të shumtën e rasteve rrethohej nga kerveti (ballkoni), po edhe ky prej lëndës drusore dhe i zbkuruar me çati të lidhur me atë të shtëpisë.

Këto lloje ndertesash kanë qenë tipike në gjithë hapsirën e Pukës dhe Mirditës dhe janë ruajtur deri vonë. Për mbulojë të këtyre banesave përdoreshin dërrasat e sëpatës, (kështu quheshin dërrasat me trashësi mbi 3-4 cm) që çaheshin nga drunjët e gështenjës, pishës, bredhit e vendoseshin mbi ngrehen, të rreshtuara dhe fiksuara mbi pallzinat (ngrehinën prej lëndësh lisi). Ata kishin jetëgjatësi më të madhe se sa baskiat, edhe këto dërrasa të holla prej bredhi zakonisht, që ishin më të lehta dhe më me pak jetëgjatësi. Rrasa e gurit, si mbulesë ka qenë një aplikim në shumë fshatra. Çatia ishte më e dystë, lëndët e ngrehës më të forta e të trasha. Ata kishin jetëgjatësi të pakufizuar, të dëmtuarat zevendësoheshin, ishte më izoluese e mirë ndaj temperaturave dhe zhurmave. Të tilla mbulesa ndeshen në fshatrat e Berishës, Komanit, Brigjeve, Bugjonit, Fierzës dhe fshatrave, ku ishte mundësia që të nxirreshin kjo llojë mbulesë. Mbuloja e banesave ka ardhur duke evoluar nga ato me rrasa guri, në dërrasa lisi deri ato me tjegulla. Ata kanë ardhur të tilla deri në vitet 60 të shekullit të XX, ku lënda drusore u zevendësua me materiale lidhëse gëlqere, çimento, mbuloja me tjegulla gurrç vendi dhe të gjera, me llomarin, eternit, etj., e deri tek përdorimi i hekurit, tullave dhe blloqeve, pllakave e materialeve të tjera bashkëkohore të ndriçimit etj.

Sot nuk gjen asnjë banesë të tillë, as për efekt studimi qoshet e mureve të jashtme, rrethimi i derës së jashtme (qemerët), e dritareve, të frëngjive, dyshekllëkut, dhe anësoret e oxhakut, janë me gurë të gdhendur. Shtëpitë me potencial ekonomik, dhe me numër të madh bagëtish, në afërsi të shtëpisë, ngrinin kasollet e bagëtive, të ndertuara në formën e piramidave, me një kulm, ose dhe me formë triangulare (trapezi), sipas numrit të krerëve, që do strehoheshin në këtë ambient të mbuluara me gjethe lisi, ose ahu, rrethuar nga një trell me hunjë shumë të lartë 2,5-3 metra, me maja të mprehta për të mos u dhënë mundësinë bishave që të depërtonin në brendësi.

Tradicionalisht malësori ka pasur edhe një banesë sezonale, në bjeshkë, kur dërgonin bagëtitë në kullota verore, tradite e cila vazhdon edhe sot. Këto njihen me emrin stane, ndërtohen me mure guri te pa lidhur me llaç, me gardh apo me purteka druri. Në afërsi hapeshin lera për grumbullim të ujit për bagëtitë. Këto stane kishin rreth e qark torishten, me rrethime me gurë për stacionimin e bagëtive në kohën e pushimit natën dhe kur milesnin. Në vende të veçanta takojmë edhe ndërtesën tre katëshe: Mertur, Berishë, dallim nga ndërtesa dy katëshe, mjediset e pritjes dhe të shërbimit për mikun ishin të vendosura në katin e 3-të dhe ajo quhej “Oda e burrave” ose “Oda e miqve”. Ajo ka një komoditet më të mirë se mjediset e tjera në këtë banesë. Dera e Odës së burrave është e vendosur gjithmonë përballë oxhakut dhe lidhen ndërmjet tyre nga një rrugicë që e ndan dhomën e burrave në dy “Margeza” ose pjesë, e madhja në te majte të oxhakut për miqtë dhe e vogla në të djathtë për burrat e shtëpisë. Një pjesë e rëndësishme e katit të tretë është divahanja, elementi më karakteristik i saj është dysheklleku. Ai ngrihet 40-50 cm nga dyshemeja dhe krijon një kënd komod ndenjeje, i shtruar me dërrasa dhe me një numër dritarësh të vogla për të vështruar natyrën. Gjithashtu në mjediset e divahanes ka shumë frëngji me funksion mbrojtës. Banesa tradicionale e trevës së Pukës përfaqëson fazën më të fundit, ku arriti përpunimi arkitektonik i banesës dhe një nga format më të përkryera të banesës së fortifikuar në Shqipërinë Veriore.

2. **ZEJTARIA** - Edhe zejtaria në popullsinë e trevës së Pukës zë fill qysh në kohët e lashta. Ka pasur mjeshtër të mirë për përpunimin e drurit, të gurit e të baltës. Përpunimi i drurit ka gjetur një përdorim të gjerë. Ai përpunohej dhe përdorej për ndërtimin e shtëpive konkretisht nxjerrjen e trarëve për banesat, të lëndëve për çatitë, të pallzinave, çarjen e dërrasave e baskijave për mbulojë, sharrimin e prodhimin e dërrasave për shtrojë, hedhjen tavanëve e ndarjen e ambienteve të banesës, ndërtimin e dritareve e dyerve, për rafte, polica, maxhe gatimi e hambar bereqetesh, dysheklleke.

**Arkat e nuseve** (sendyqe) për të vënë çezin e nuseve dhe të grave ndërtoheshin nga zdrukhtarë specialistë dhe zbukuroheshin me gëdhendje të figurinave të ndryshme dhe ornamenteve sipas porosive. Teknikat e punimit-kombinimi i motiveve dhe i ngjyrave të përdorura me finesë dhe shije artistike tregojnë për nivelin kulturor dhe talentin e zejtareve vendas, Dukagjinas, në stadi të ndryshme të zhvillimit shoqëror. Punoheshin vegla punë, ene kuzhine dhe “tpi” ’mti” (dybek), bluda, lugë druri, korita, për punimin e qumështit dhe larje rrobash, vekë (tezgjah) për punimin e leshit, veglave bujqësore, parmenda, zhgedha etj. për bërjen e instrumenteve popullore: lahutë, zumare, çifteli, sharki daulle dhe elementët e saj me dru, me zgjdhje (ato që gdhendeshin), punoheshin **djepa**, të cilat zbukuroheshin me figura në anësoret e tij dhe tek **kaptelli** (pjesa harkore) me figura si gjarpri (për syrin e keq), më vonë edhe me ngjyrimë. Gdhendje guri e përgatitje: oxhaqesh, qoshe shtëpishë, qemer dyersh e dritarësh, gurë krojesh, rrethim bunarësh; materiale për furrat e bukës. Përgatitja e gurëve të mullinjëve të blojes, të moknave etj. Moknat ishin mullinjë, që bluanin drithërat në kushte shtëpie, me gur të vegjël të cilës guri i sillej me forcën e krahut. Përdorej për kohë të keqe, në raste emergjente, apo nga familjet që ishin të ngjuara. Mullinjtë e blojës punonin me ujë, kjo veprimtari është e vjetër dhe ka rendësi të posaçme ekonomike, ata shërbenin për bluarjen e drithërave për nevojat e fshatarëve. Ato janë të vendosura anash lumenjve ose përrrenjëve me prurje gjithëvjetore uji.

**Enë prej druri dhe vegla pune: Tinari (gavixhi)**- është një ene druri me përmasa të mëdha mbi 3-4 quintalshe për depozitimin e rrushit dhe të frutave të tjera për përgatitjen e bërsive për zierjen e rakisë, nxjerrjen e verës dhe të mushtit. Kjo enë ndërtohet me degë, që lidhen në formë rrethore dhe ngjishen me rrathët anësor. Në fund vendoset një tub druri, i cili shërben për nxjerrjen e verës, apo dhe të mushtit. Pas zierjes së rakisë, shtëpitë numerike e mbushnin me lakra dhe bënin turshi, po nga tubi nxirnin lengun e lakrave të regjura dhe e pinin si aperitiv. **Sheka** në formë tinari (vozge), por me përmasa më të vogla se tinari, përdorej gjerësisht për djathin, për turshi; **shtrunga**- (ene druri për mjeljen e bagëtive), **lugje druri** (ene) hedhjen e qumështit pasi milet dhe vlohët për tu ndarë korja e tamlit (maza) e cila pasi grumbullohet për disa ditë tundet dhe nxirret gjalpi, i cili pasi vlohët ndanë tlynin (gjalp i shkrirë): **tpi** (ti) vegël e përgatitur nga mjeshtër popullor nga druri i bredhit e panjes i gjatë mbi një meter i ngushtë



në majë dhe i gjërë në fund, i cili përdoret për të rrahur qumështin e për ta kthyer në gjalpë, **pehar e luge druri, bluda** (sahan) për ngrënie etj. **Sofra** apo (tervesa) me dru bredhi ose mlike (lloj pishe), pasi nuk ka aromë dhe nuk lëshon rrëshirë, të madhësive të ndryshme, për odat e burrave, për fëmijë, për pak njerëz për ngrënie buke **magje** për të mbajtur miellin për bukë, me elementët e saj( një arkë e madhe me kapak e ndarë në brendësi **prehri**, vendi ku përvëlohet e përzihet mielli, ngjishet e përgatitet për ta shtrirë në **fundin e bukës** (mjet rrethor në madhësinë e rrasës së furrës në të cilën shtrihet brumi, i jepet forma e bukës, zbukurohet nga maxhatorja dhe pasi përpushet (largohet hiri dhe ezçlli-prushi) pastrohet rrasa e furrës, mirret fundi për bishti dhe me delikatesën e sigurinë e maxhatores shtrihet në këtë rrasë dhe pasi i vihet dera furrës, kontrollohet herë pas here në se është duke u pjekur, apo po mbipiqet (digjet). Janë përgatitur edhe **rrathët** për tu vene poshtë këmbeve për të ecur në dëbore, për të mundësuar lëvizjen e lirë në rastet e pamundësisë së qarkullimit, kur binin reshje të shumta dëbore. Gjithashtu me dru punoheshin **vegla punë**. Parmenda me pjesët përbërëse të saj: shti e zgjedhe, vllaç, bishta te mjeteve te punës etj.

**Përpunimi i baltës dhe i qerpiqit.** Në afërsi të secilës Kala gjejmë gurët e farkës, që janë gur të formuar nga skorjet e shkrirjes e përpunimit të metaleve nga paraardhësit tanë, fisi i Pirustëve, ata përdoren për dhçnjën e kubesh dhe harkut të furrës pjekëse, pasi më të qendrueshëm, janë të pastër, nxehen shpejt dhe ruajnë nxehtësinë. Gjejmë dëshmi të veglave dhe enëve të baltës dhe të qeramikës. Por edhe si trashëgimi ajo është përqafuar dhe përcjellë deri në vitet e vona: prodhimi i tjegullave, prerja e tullave, punimi i enëve për lëngje Vorba (vegsha), çerep për pjekjen e bukës, enë për servirjen e ushqimeve, ku dalloheshin zejtarët e Kabashit, të Gojanit, të Spasit, sakatit, Gralishtit etj. Jo vetëm të dalluar kanë qenë zejtarët e mjeshtrit popullor në përpunimin e gurit, drurit, baltës e qeramikës, por janë përdorur edhe **thuprat** e ahut, shkozës, lajthisë, bungut, shelnjes(shelgut) e bimësisë tjetër të lakueshme. Me to janë prodhuar që nga kosherja e faratores, kosherja e mesme për vjeljen e frutave nga pemët, e mbartjes së perimeve nga kopshtijet, koshat për transportin e prodhimeve bujqësore, por edhe e koshave për mbledhjen e dushkut të bimësisë në male për ta kthyer në humus për parcelat e arave për të përmirësuar strukturën e tokës dhe siguruar rendimentin e duhur në mirëritjen e zhvillimin e drithrave, të perimeve dhe frutave. Me thupra janë ndertuar koshat (koçekët) e misrit, gardhiqet, ndarjet e vathnive për ndarjen e bagëtive sipas llojit, moshës e gjinisë, janë thurur torishtat (trellet), janë përgatitur shkalca(lesa) për transport, anë qerresh, etj.

### **Disa nga veglat frymore dhe instrumentet popullore tradicionale të trashëguara në nga lashtësia**

Instrumentet muzikore tradicionale janë një nga pasuritë e rralla të kulturës së trevës së Pukës e Dukagjinit. Mjeshtëria e punimit të veglave muzikore përbën një zeje të veçantë, në zejtarinë shqiptare. Punimi i instrumenteve muzikor fillimisht bëhej vetë, nga çdo familje me mjete rrethore si p.sh. me gjethe, me barëra, me bimë të ndryshme, me brirë, me lëkurë kafshësh, me gurë, me hekur, etj. Në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe fillim të shek. XX, filluan të hapen punishtet e para të punimit të veglave muzikore. Zanafilla e veglave muzikore fillon me lahutën, instrument kordofon me një tel, me të cilën malësorët shoqëruan këngët epike të Ciklit të Kreshnikëve. Ky instrument i hershëm i përdorur gjërisht në treven e Dukagjinit (Pukës) ka qenë dhe përdoret edhe sot, i cili ka evoluar në etapa të ndryshme, bashkë me evoluimin e përparimin e shoqërisë. Fillimisht ai shte përgatitur me dru të gërryer të pa zbukuruar, më pas sipas rrëfenjave takohet, lahuta me kapak breshke, më vonë me kungull (me porceke pulik) dhe se fundmi me punim druri. Ajo zbukurohej me figura që nga gjarpri, shqiponja, me flamurin kombëtar, me emblemën e Kastrioteve dhe të familjeve udhëheqëse, etj. Ky instrument është i lashtë, sa vetë banorët që populluan trevën tonë dhe malësinë e Dukagjinit. Padrejtësia që i bëhet fillimeve të përdorimit si dhe të evoluimit të këtij instrumenti bashkëshoqërues të banorëve të trevave Dukagjinase, duke ia “dhuruar autoktonsinë serbëve” është fyerja më e madhe që i bëhet kësaj trashëgimie etnografike e kulturore, për të cilën nuk është bërë asnjë përpjekje e luftë ballafaquese për këtë përfaqësim.

Nëpër kullota me bagëti barinj të kalonin kohën nën tingujt e ngrohtë të gjethit, të zumares, të fyellit e të bilbilit, të cilët kanë pasë një përdorim shumë të hershëm dhe kanë qenë të lidhura kryesisht me jetën baritore. Malësorët këngët dhe vallet i shoqëruan gjithashtu me tingujt e ëmbël të çiftelisë. **Veglat muzikore** të përdorura në dasma, në festa familjare e në gëzime kanë qenë kryesisht: lahuta, çiftelia, sharkia (më vonë), tupani ose lodra dhe dajrja (defi). **Dajre**- apo def, i përdorur pothuajse në të njëjtën formë që gjendet edhe sot. **Fyelli**- me dru krejt të thjeshtë e deri në një punim me dru me ornamente artistike e tek tunxhi. **Brini**- është ndër instrumentet e lashta, që zejtarët fare pak kanë vene dore mbi te, sepse atij i përshtateshin vrimat dhe i ngjitej pipi e përdorej nga instrumentistët. **Kavalli**- është punuar me dru krejt të thjeshtë e ka ardhur deri tek punimi me dru, por me dekor e ornamente të ndryshme.

#### 4. Këngët

Kjo treve dallon edhe për shumëllojshmëri të këngëve. Disa nga llojet e këngëve popullore tradicionale janë: Këngët e Kushtrimit (haberit). Kushtrimin në Malësinë e Pukës e njihnin të gjithë, i madh dhe i vogël, si thirrje për luftë, për mbrojtjen e atdheut, thirrje e sihariqe, por edhe lajmçrime për fatkeqësi. Thirrja përcillej e shkonte gojë më gojë, nga fshati në fshat, nga krahina në krahinë me shpejtësi shumë të madhe. Çdo mënjanim nga thirrja mbulohej me turp për atë që nuk i përgjigjej, por edhe dënohej nga fisi me denime shumë të ashpra. Jehona shpat më shpat përhapej: “*Hiq kushtrim nga një burrë për shtëpi*” apo “*O hiq kush të jesh burrë në shtatë e shtatëdhjetë*”!

**Këngët e kreshnikeve** të cilat janë shumë të lashta dhe këndohen të shoqëruara me lahute, janë kënge epike luftërash dhe interpretohen me përmallim, dhimbje, krenari etj.

**Këngët e trimave** u këndohen individëve të shquar, që kanë bërë trimëri. Edhe këto këndohen të shoqëruara me lahute.

**Kënge maje krahit** (përpjetë, habertare, asqerçe) këndohen zakonisht nga dy burra së bashku, duke vene gishtat në vesh e duke thirrur fort. Janë të shkurtra si tekst.

**Këngë tematike** (të punës, natyrës, jetës, dashurisë) këndohen nga burrat të shoqëruara me çifteli. **Këngët e çikave** - i këndojnë vajzat e reja në kullota, në bjeshkë, në dasma, festa etj, ato krijohen nga vete çikat dhe u shtohen vargje sipas momenteve e mjedisëve të interpretimit të tyre.

**Këngët me tepsi**, edhe këto kënge dasme këndohen në kor, ku grupi ia përcjell grupit të lidhura krah për krah (vajza e gra) ose përballe njëra - tjetrës dialogojnë.

**Këngët humoristike** të cilat përcjellin gëzimet, lojrat në dasma e ahengje, në bjeshkë e në vrri, në të mbjella e në të korra,

**Këngët e kapuçave** edhe këto këngë liriko satirike, që këndohen në lojën e kapuçave, ku pala fituese satirizon palën humbëse në mënyrën më miqësore, me vargje të krijuara (improvizuara) në çast, apo dhe të kujtuara nga arsenalit i kësaj gjinie, por me bonsensin e pranimit dhe të mirëkuptimit nga pala humbëse.

**Këngët e djepit** si krijimtari gojore popullore të çastit, apo dhe të trashëguara dhe të përcjellura nga goja në gojë e shprehjes së dëshirave për rrugën dhe të ardhmen e krijesës së re, që përkundin në djep.

**Këngët e punës**, (terthur, pa instrument, pa ndërprerë punën), që këndohen nga burrat dyshe e në grup në prashitje, në kositje, e në punë të tjera që shërbejnë për ngritjen e gjendjes shpirtore të grupit dhe mobilizim për punë. Të tilla këngë janë kënduar edhe nga luftëtarët që janë nisur në drejtim të pozicionimit për qendresë ndaj armikut pushtues.

**Këngët e vajit** janë këngë elegjike për humbjet e dhimbshme njerëzore, të cilat interpretohen nga burrat dhe nga gratë, të shoqëruara me instrumentin bazë popullor, lahutën, fyellin, zumaren, çiftelin etj.

Në këtë kuadër kemi edhe *gjamën, një nënshtrësë e elegjisë*, gjama e burrave të Anës së epër (brigjeve, Berishë, Mertur) dhe të grave, ku dallojnë vajtoret e Mirditës. Aq në detaje ato e përcjellin jetën dhe veprimtarinë, lidhjet familjare, miqësore shoqërore të të vdekurit, saqë arrijnë të përfshijnë në vaj gjithë pjesëmarrësit në morte.

## 5. Vallet

Janë bashkudhëtare në rrugën e gjate te historisë dhe pjesë përbërëse e jetës shpirtore te popullit te trevës së Pukës. Ato shquhen për dinamizëm, forcën, epizmin dhe lirizmin e tyre. Vallja është kërcyer tradicionalisht në malësi, por me tepër ate e ka kërcyer fisi i Kabashit, i cili ka edhe vallen e tij katërshe (Vallja e Kabashit). Kjo është një valle epike. Ajo kërcëhet nga 4 burra të cilët formojnë një rreth të mbyllur. Valltarët qëndrojnë perballë njeri tjetrit. Sipas të dhënave gojore thuhet se numri 4 përfaqësonte 4 vllaznit e fisit të Kabashit si: Qafaliajt, Kokajt, Lushajt dhe Hadrojin. Vallja ka karakteristikë të saj hapjen e krahëve anash, rrahjen e kembëve në tokë etj. Kjo është në nder vallet më të kërcyera nëpër dasma jo vetëm në zonën e Pukës, por edhe jashtë saj. Tipari dallues i valleve popullore të burrave është forca e dinamizmi. Ato ndonëse karakterizohen nga spontaniteti në interpretim, kane edhe një tematike te caktuar. Ndërkaq vallet e grave janë teje dinamike, elegante, here- here shpërthyesë, por edhe të shtruara, plot krenari dhe hijeshi.

## 6. Veshjet

Gratë e të gjitha fshatrave të trevës së Pukës e të Mirditës janë dalluar dhe kanë trashëguar nga brezat zejen e përpunimit të leshit, të lirit dhe të shajakut. Ata kanë tjuerur e dredhur deri në limitet e fijeve së flokut leshin e deles, e kanë ngjyrosur dhe, me të kanë përgatitur gajtanë për tirqe e xhubleta, kanë endur materialin bazë për tirqit, për xhubletat, kanë endur qilima, cerga e sixhade, strajca etj. Disa prej tyre e kane origjine tejet te hershme : si veshja me xhublete e grave te Berishës, Merturit, Iballës dhe brigjeve : veshja me tirq zhguni te bardhe dhe me ngjyre të zeze me jelek apo xhamadan; veshja e ngushte dhe e gjane për gratë, etj. Në Malësinë e Dukagjinit (Pukës) tradicionalisht kanë qenë përdorur, dhe fatmirësisht ka filluar ringjallja e përdorimit të shumë varianteve të veshjeve popullore, këto në evente gëzimesh, në festa e festivale, në ceremoni dasmash e ditëlindjesh. Për burrat përdorën veshjet me tirq dhe me kapuçin e bardhe në kokë i cili vihet mënjanë në zonën e trevës së Pukës, cepi i të cilit i vjen makullit në vetull te syri, rreth të cilit lidhet diagonal një shami shami e kuqe apo me ngjyrë tjetër sipas gjendjes emocionale që përjeton apo mbart burri në at çast. Ndërsa në Mirditë takojmë veshjen e burrave me tirqe xhamadan dhe kapuç të rrafshhtë. Treva e Pukës dhe e Mirditës është e pasur me veshje popullore. Për Mirditën kërkohet hapsirë më e madhe për trajtimin e veshjes së vajzës, nuses dhe grave, po ashtu edhe për ritet e fejesës, së vajzës e djalit, për fenë (dasmën) e vajzës e të djalit, për ritet e lindjes, kumarinë, dhe ndarjen nga jeta. Gjithësesi shumë elemente janë huazuar nga njeri- tjetri, si rrjedhim i jetës së përbashkët. Si kufiarë, ata kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të thirrur (ftuar) në gëzimet e njeri- tjetrit, marrin pjesë dhe urojnë për festat fetare njeri- tjetrit, marrin pjesë në ngushëllimet tek njeri- tjetri. Kështu që pothuajse dallimet janë të pakta, megjithëse treva e Pukës, (bajraçet e saj) janë më luajalë, më tolerant, ndërsa Mirditorët janë shumë besnik ndaj respektimit të të gjitha rregullave e sulleve, që kanë qenë e janë të bashkëpranuara.

### Veshja e gjanë e grave pukjane

Kjo veshje ka edhe komponentë te vet. Për të bërë kanacin përdorëshin dy fletë pëlhere të leshtë të endura në vegjë me katër lisa (liq), me gjatësi: 3m dhe gjerësi 30cm, të cilat qepeshin me dorë me njëra- tjetrën. Puna më e lodhshme ishte përgatitja e palave (turrimi duke i hedhur ujë sa më të ngrohtë). Për këtë në çdo 2 cm pëlhurë kthehej një palë dhe përshkohej me gjilpërë me penj nga kreu deri në fund. Mbasi përfundonte përshkimi, pëlhura e mbledhur nga qepja, thahej, ngjyrosej me bojë të kuqe në kafe, lihej për një kohë të gjatë të thahej në hije, më pas i hiqeshin fijet e qepjes së palëve dhe kanaci ishte gati të përdorej. Këmisha e bezit, me krahë të shkurtër deri në bërryl dhe te gjerç, e qëndisur, e gjatë deri

tek kofshët. Pjesa përpara, në gjoks, është e qëndisur me pej me ngjyra. Knaci zbukurohet me rreza e me xhixha. Në fund i ngjitet një shirit (liqar), jo i gjerë, zbukuroes i bardhe ose me një ngjyrë tjetër që të vijë në harmoni me ngjyrat e zbukurimeve të tjara.

**Mitani (xhamadani)** pa mange punohet me cope te zezç, kafe apo të kuqe, futet në dy krahët, por nuk komcohet (mbërthehet) dhe nuk ka mangç të gjata. Është i shkurtër sa nuk arrin deri në bel, është i qëndisur dhe i zbukuroar me lule dhe ornamente të ndryshme. Veshja me “**xhublete**”: xhubletë, jelek me thekë, brez, serme, çorape leshi të zeza, opinga lëkure, shami me thekë dhe zbukurime dhe serme të shumta, përbën të veçantat e saj në këtë trashëgimi dhe vlerë, e cila është përdorur në Brigje, në Berishë, Thaç, Merur, Iballë

**Mestet (shputat)** bëhen me kërrabëza, me pe leshi të dredhur dhe qëndisen me ojme te ndryshme. Si për burrat dhe për gratë ato kanë veçansitë e tyre. Leshi zgjidhet, turet bukur dhe mendohen lulet dhe ornamentet e tjera zbukuroese, sipas moshave. Përdoren sipër tyre edhe shputat. Ata zakonisht punoheshin me penjë të dredhur, me ngjyra dhe lule,

**Çorapet e shputat e grave**, e të rejave qëndiseshin edhe me fije ari.

**Opinga (opangat)**, bëheshin me lëkure lope, te bëra anash me dredhç (lëkure e prerç si spango). Pjesa e sipërme e punuar me qëndisje me pej me ngjyra të ndryshme.

### **Veshja e burrave**

Në kompletin e veshjes së burrave bëjnë pjesë:

**Tirqit** të cilat punohen me cope prej leshi të endur në vegje (vek), i cili pasi ka kaluar në vajanice, duke u shkelur e kthyer në zhgun. (Vajanica ka qenë një makineri e cila vihej në lëvizje nga uji dhe realizonte shkeljen e ngjeshjen e endjeve (pëlhurave) të leshta. Të tilla ka patur në zona të ndryshme: në Bardhet (Qafç Mali, Berishë, Qelëz etj). Ai më pas është ngjyrosur sipas nevojave dhe i është dhënë prestarëve për të prerë e qepur veshjen (mashkullore) të burrave e të rinjëvë. Tirqit ishin prej shajaku të bardhë të endur në vegjë me dy lisa (liq). Prerja dhe qepja bëhej nga katër pjesë: balli i shkecut, balli i kofshëve, prapanica (bytheci) dhe paranica. Para se të fillonte qepja, përgatiteshin gajtanët, duke i qepur së bashku 14-16 fije. Fillimisht bënin shkekat (në vend të xhepit), ku veç fijeve të bashkuara, zbukuroheshin me një përdredhçë gajtanash në formë gërsheti nga brenda dhe forma lulesh jashtë linjës kryesore. Rëndësi i kushtohej edhe këmbëzave, mbi shputat e të cilave vendoseshin në formë vezake dy shirita me 14-16 fije. Bashkimi i pjesëve të prera bëhej njëherësh duke i përshtatur edhe shiritat e gjerë të përgatitur me gajtanë leshi të zi.

**Guna (guja)** kishte formën e xhaketës së mëvonshme, por me krahë të shkurtër e të gjërë. Ishte prej shajaku leshi. Mbi krahë kishte **kacurretën**, copa e gjatë deri te shpatullat.

**Xhamadani i kuq** ishte me krahë, i zbukuroar me qëndisma. Përdorej për raste ceremoniale. Xhamadani i zakonshëm përdorej pa krahë i thjeshtë, i leshtë, por më vonë prej pëlhure. Veshja e burrave me tirq, kësulë dhe xhamadan të kuq deri në vitet '30 të shek. XX disa trima kanë vënë 1-2 kësula njëra mbi tjetrën me largësi 1-2 cm.

**Këmisha** – punohej prej bezes, me mëngë të gjata, pa jakë, me grykë rrethore të hapur dhe e punuar me qëndisje me një dizajn të lehtë me pe të bardhë.

**Jeleku** përbehej prej shtroje copë e zezë apo kafe e mëndafshit dhe e qëndisur grykët, gjoksorin dhe mëngët me fije të trasha mëndafshi me ngjyrë ari.

**Shoke** (brezi) punohej prej leshi në vegje e kombinuar me pe të ngjyrosur afërsisht me ngjyrat e ylberit, e gjatë sa sillet disa herë rreth mesit. Malësia e Dukagjinit (Pukës e më gjërë) është një ndër trevat, që dallohet për shumëllojshmëri e varianteve, te ngjyrave dhe të motiveve të kostumeve popullore. Kostumi popullor e hijeshon dhe e bën më krenar, e madhështon gruan dhe burrin, djalën dhe vajzën.

### **Dasma si element i etnografisë së dasmës në trevën e Pukës**

Fazat nëpër të cilat kalonte dasma në trevën e Pukës. Martesa e djalit është quajtur dasëm, ndërsa martesa e vajzës është quajtur në të folmen e Pukës **FE**, sepse në shtëpinë e prindërve të vajzës nuk krijohet atmosferë dasme njësoj si për djalin. Kryesore në dasmë ishte veshja kombëtare, sidomos e grave, e cila karakterizohet nga një veshje origjinale, që nga shamia e kuqe ose e verdhë, atllas me thekë, sipas ngjyrës së shamisë, kapuçi me rruaza e pare për nuset, me bistekë të stolitur bukur me rruaza.

**Fejesa e djalit** me vajzën, në të kaluarën kryhej me shkues, ndërmjetës. Fejesa bëhej me mirëkuptimin e familjeve të djalit dhe të vajzës. Kërkesën për fejesë e bënte ana e djalit. Gjithmonë fejesat kishin parasysh, që të bësheshin mes familjeve të njohura për virtyte. Për arritjen e marrëveshjes së familjeve, shkuesit i duhej të shkonte disa herë te familja e vajzës, derisa ajo të bindej. Shkuesi e kishte për detyrim moral të lavdëronte djalin dhe familjen e tij, por edhe te familja e djalit lavdëronte familjen e vajzës dhe vetë vajzën. Ndonjëherë ndodhte që shkuesi edhe i shtonte, i lavdëronte familjet pa i merituar ato epitete, vetëm e vetëm për ta kryer punën e shkuesisë, apo pajtimin e familjeve për t'u miqësuar. Shpesh ndodhte, që shkuesit familja e djalit i premtonte edhe çmime të majme parash e peshqesh, vetëm e vetëm për ta kryer fejesën e djalit me vajzën, që dëshironin. Ndodhte që shkuesi të dilte edhe qesharak nga lëndat e familjes së djalit dhe vetë djalit apo anasjelltas, familjen e vajzës apo vajzën. Kanë ndodhur fejesa që në moshë të hershme, bile edhe që në djep, e në raste të veçanta qysh në barkun e nanës.

**Fejesa e vajzës.** Sapo arrihej pëlqimi dhe pajtimi i familjeve, shkuesi, vetëm apo me ndonjë person të afërm të familjes së djalit, shkonin te familja e vajzës për ta "pre fjalën" e vajzës ose pëlqimin për fejesë, pëlqimin e familjes së vajzës. Me rastin e shkuarjes së shkuesit, familja e vajzës, përgatiste një darkë për shkuesin me shoqëruesit e tij. Pasi hanin darkë, shkuesi i drejtohej të zotit të shtëpisë, që zakonisht ishte i ati i vajzës: (O filani!),- ta kemi mësy shtëpinë për me na e dhanë çikën për djalin e filanit. Dhe niste të fliste mirë për djalin dhe familjen e tij brez pas brezi. I zoti i shtëpisë, apo i ati i vajzës, pasi e falënderonte shkuesin me të tjtë për vlerësimin e treguar ndaj familjes së tij, nuk ia jepte menjëherë fjalën. Të nesërmen, kur pinin kafën e mëngjesit dhe kryefamiljari e gjykonte, se nuk kishte për të pyetur njeri tjetër, u thoshte, se ishte dakord dhe u caktonte një ditë, jo më shumë se një javë, kur do të vinin njerëzit e afërt të djalit për të sjellë "shejin" (rizë dhe unazë). Kur ai e gjykonte, se do të pyeste të afërmit e tij, sidomos dajën e vajzës, siç e donte zakoni, i caktonte një afat dy-tre ditor për të marrë përgjigjen përfundimtare. Pas "dhënies së fjalës", nga familja e djalit organizohej çuarja "e shejit". Pasi binin dakord të dy familjet nga ana e djalit shkonte babai i shoqëruar nga dy ose tre të afërm. Tek shtëpia e vajzës përgatitej darka dhe për të marrë pjesë në të ftoheshin të afërmit e familjes, bija, nipa, mbesa etj. Pasi hanin darkë, babai i djalit thoshte se kishte sjellë "shejin". "Sheji" përbëhej nga një rizë, shami mëndafshi, dhe një unazë model i Delmaces, të cilat ia dorëzonte nënës së vajzës, duke i thënë: Për hair! T'i gëzoftë!

Këto fjalë i thoshin të gjithë të pranishmit, si ata të djalit dhe të vajzës. Nëna e vajzës i merrte këto dhe i ruante në arkën e saj dhe ia dorëzonte së bijës ditën, kur vishej nuse. Në "shejin" e nuses, që sillnin njerëzit e djalit, përveç rizës dhe unazës, kishte zakonisht veshje dhe një shumë parash. Këto i nxirrte nga dujqit njëra nga gratë e shtëpisë së vajzës dhe i tregonte për t'i parë të gjithë dhe njëkohësisht thoshte me zë emrin e veshjes ose dhuratës. Pas kësaj, i ati i vajzës shtronte kushtet, që do të plotësonte familja e djalit, që kishin të bënin sidomos me pajën, siç ishin veshjet, rrobat e fjetjes etj. Vetëm pasi mbaronin të gjitha këto, të gjithë të pranishmëve u sillej nga një kafe. Kur e mbaronin, secili uronte "Për hair!" I ati i dhëndrit linte në tabaka një sasi paresh me vlerën e dy napolanave të floririt. Për përgatitjen e pajës punonte vetë nusja dhe të afërmet e saj, gjithnjë sipas përcaktimit që kishin bërë më parë. Këto ishin kryesisht punime prej leshi si çorape, qendisma, kryesisht që planifikoheshin për të falmet etj. Pak ditë para dasmës të dy palët bënin "Shtegun e Shkodrës", të Gjakovës ose Prizrenit, për të blerë ato gjëra që nevojiteshin të veshmbathjes dhe të fjetjes, që nuk mund t'i përgatitshin vetë. Vetëm kur çohej "sheji"

dhe piheshin kafet si vajza, si djali quheshin të fejuar. Dasma e vajzës bëhej ditën e mërkurë ose të shtunë. Ishte traditë që vajza të mos ishte në dijeni për ditën e martesës, me qëllim, që ajo të mos dëshpërohej, se po ndahej përgjithmonë nga prindërit dhe familja. Pasi gratë e shtëpisë kishin bërë gati çdo gjë tjetër për ceremonin e martesës, gratë e shtëpisë mblidhen dhe bisedojnë, se kush do t'i thotë vajzës për ditën e dasmës. Vajza, përpara se të ngrihej në mëngjes e të vazhdonte punët e ditës, një grua e shtëpisë e thërriste pranë dhe i thoshte: “Eja e ngrihu, se je e zënë dhe nuk do të dalësh përjashta, sepse nesër a pasnesër shkon nuse”. Vajza futej në dhomë dhe fillon të qante. Ishte turp të mos qante në dhomë. Një grua e shtëpisë, zakonisht e ditur, që quhej për rastin “veshatarja”, merrej me stolisjen e nuses. Ardhja e të ftuarve, sidomos bijave, dajave, xhaxhallarëve e nipave dhe mbesave shënonte fillimin e dasmës së vajzës (fesë). Vendoseshin burrat veç dhe gratë veç. Në dasmën e djalit ose të vajzës janë luajtur edhe valle të kënduara që luheshin nga 4-6 gra.

### ***Fjalorth***

1. Kallkan/i e/t: - em.gj.mashk. Pjesa murit që ngrihet në dy anët e ngushta të ndërtesës dhe sherban si mbështetje për çatinë, ndihmon për shfrytëzimin e çatisë për mjedise banimi, sepse ngreha merr pjerrtësi dhe ndihmon kullimin e reshjeve të shiut dhe rreshqitjen e dëborës, forma e pjerrtë pakson edhe erën (formë aerodinamike)
2. Trell /i – e. gj.fem. Torishtë/a, .Pjesa e rrethuar rreth kasolles së bagëtive, e cila mundëson qendrimin jashtë të bagëtive, në fresk në kohën e verës, po edhe në dimër.
3. Kopanxhë = em.gj.f. Zevrek Pjesë e hapur në një cep të katit të një ambienti, i cili sherben për të kaluar nga një ambient i ultë në një ambient më të lartë nga njeri kat në tjetrin duke shfrytëzuar shkallët. Mbyllet me kapak që të mos dukej. Në shtëpitë dykatëshe e më shumë katëshe lëvizja nga brenda nga kati në kat, apo në tavan kryhej nëpërmjet shkallëve dhe kopanxhave. Kapak kopanxhe, mbylle, hape kopanxhën,
4. Baski/a = em.gj.f Dërrasa të holla të çara me kujdes nga druri i bredhit me gjatësi rreth 1 m gjërësi, 10 -15cm, trashësi 1,5-2.5 cm , përdoren për të mbuluar çatinë. Janë të lehta, fiksohen me gozhdë, thahen shumë shpejt pas reshjeve, nuk kanë jetëgjatësi mbi 25-30 vjetësh
5. Kervet/i = em.gj,m (takohet edhe kervet në zona të ndryshme) Ballkon, që i shtohet nga jashtë jerevisë me gjatësinë e murit anësor, me mbulojë me çatinë, me një gjërësi 1.5 metra, që del mbi trell, ndertuar me dërrasa, të cilat vihen mbi trenët, të cilat lihen enkas të gjata jashtë murit për këtë qëllim. Shfrytëzohej nga shtëpiakët, për ngritjen e qarranikut të bylmetit, për qendrim në fresk, për tharejn e frutave, nderjen e tharjen e rrobave e ndresave, për mbrojtjen e pjesës para derës së bagëtive nga reshjet e ruajtjen e bazës ushqimore nën të. Lidhet me shkallë nga jashtë nëpërmjet një dere e cila mbyllet me dry, ndersa në anën tjetër pengohet hipja në të.
6. Ngrëhë/a=em.gj.fem. Çatia e shtëpisë, pjesa e lëndëve, të cilat fiksohen në trarët e katit dhe lidhen në kulmore, forcohen e lidhen njera me tjetrën me cupila e mbështetën në dumanët. Ngrëhë e pjarrët, e ultë, ngrëhë për tjegulla vendi, për tjegulla fabrike, ngrëhë për rrasa. Lëndët e ngrëhës nxirren me hanë që të mos i bluaj tenja(molja) etj...
7. Lerë/a/at.= em.gj. fem. Pellgje, puse të hapura në bjeshkë e kullosa, për mbledhjen e ujit të reshjeve të shiut e dëborës, për ta përdorur bagëtia për pirje në ato vende, ku nuk ka burime ujore.
8. “Margez/a em.gj.fem= pjesa e ndarë e dhomës në të dy anët qoshet e oxhakut, e shtruar me qilima, cerga e sixhade, njera përdoret për miqtë e njerëzit e rendësishëm të shtëpisë, ndërsa pjesa tjetër që ka edhe raftin në mur të takameve të kafes rri i zoti i shtëpisë. Markëza e madhe, markëza e vogël

9. Divahane/nja = em.gj.fem= korridor, rrugicë, e cila është vendi nga organizohet hapja e dyerve për ambientet e banimit dhe shfrytëzimit dhe ka lidhje direkte me derën e jashtme të hyrjes. Dolin në divahane( korridor, rrugicë) .
10. Dysheklllek/u.= em.gj.mashk. vend i ngritur në divahanan e kullave , ku rrinë djelmëria në kohë fresku, afër frengjive të kullës prej të cilave kontrollohej rruga, dhe organizohej mbrojtja e kullës.

## **PËRFUNDIME**

1. Shqipëria njihet si një ndër vendet me tolerancë ndërjetare më liberalet.
2. Malësia e Dukagjinit dhe malësitë e tjera përrreth përbëjnë një shembull nga më të veçantët e të admirueshmit në Shqipëri.
3. Udhëtimet dhe bashkëpunimi i ndërsjelltë mes njerëzve nga Puka, Mirdita, Shkodra, Malësia e Gjakovës, Kukësi, Prizreni, etj, kanë bërë që t’u shërbehet njeri- tjetrit, të priten e të përcillen, të marrin e të japin nga njeri-tjetri, pra të ndërtojnë marrëdhënie mirëbesimi, respekti ndërpersonal.
4. Kështu u miqësuan lidhën kumari (qethja e fëmijëve, elementi bazë i marrëdhënieve të besimit të ndërsjelltë). Në raste festash fetare u ftuan tek njeri-tjetri.
5. Në këtë mënyrë mardhëniet ndërjetare erdhën duke u forcuar dhe besimi mes tyre të rritet. Edhe pse kishin besime të ndryshme, kishin moral të njejtë, besnikërinë, mikpritjen, burrërinë, besën, kishin armikun e përbashkët ndaj mbronin njeri – tjetrin, pasi nuk i ndante gjë, dhe nuk i lidhte gjë me pushtuesin.
6. Kishte brenda një fshati banorë me besime të ndryshme, bile edhe brenda të së njejtës familje.
7. Çdo pushtues, që ka kaluar në tokat tona nuk ka mundur që ta ndryshojë unitetin, mirëkuptimin, harmoninë, respektin në mes komuniteteve me besim të ndryshëm. Kisha dhe Xhamia kanë bashkëjetuar në shekuj ne Puke, pa i ra ndesh njera-tjetres. Kete realitet e fakton dukshem rapsodi, poeti i Kabashit, “artist i merituar”, Prendush Gega me 1903 ne vagjet si keto:
8. *“Ti n’Kabash ndojher je kan / E ke pa ni xhami n’lam?! / Aty nget ni kish ish kane / Dere per dere kish’ e xhami.*
9. Aq lidhje e besim u vendos mes dy komuniteteve, sa në kohën e pushtimit turk, kur taksidari vinte për të taksuar familjet muslimane, të fiseve të epra të Pukës, Kabashit, banorët e kalonin mallin e gjenë e gjallë tek familjet e besimit katolik Mirditore, se ato ishin të përjashtuara nga taksat, deri sa ata të largoheshin nga fshati, për të mos paguar taksa të larta.
10. Kjo praktikë është aplikuar për dhjetra e dhjetra vite, duke ndihmuar njeri-tjetrin.
11. Bashkoheshin në çeta të përbashkëta dhe u bënë pritë karvaneve turke e sërbe, u shkonin në ndihmë e mbështetje, sapo jepej kushtrimi e thirrja për mbrojtje.

## **STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA**

1. Ibrahim Malaj, ‘Udhëtimet e Malësorëve’
2. Riza Tafilaku, ‘Visare të Kulturës Pukjane’
3. Xh.Meçi, ‘Kanuni i Lek Dukagjinit, variant i Pukës’
4. Fjalori Enciklopedik
5. Nazife Ramadani, ‘Shikim etnografik’
6. Intervista e mbledhje kujtimesh nga të moshuarit në vite nga arkivi personal.